

## Titulli i lëndës: MJEKËSI INTERNE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekesise
Titulli i lëndës:	Mjekësi Interne (drejtimi: Stomatologji)
Niveli:	Bachelor, Master
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i V dhe VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2/ 1+2
Kreditë ECTS:	7
Koha / Vendi:	Sipas orarit/ Klinikat Interne
Mësimdhënësi:	Prof.ass. Shemsedin Sadiku Prof.dr. Shpend Elezi Prof.dr. Gani Bajraktari Prof.asoc. Ibrahim Rudhani Prof.ass. Aurora Bakalli Prof.ass. Venera Berisha-Muharremi Ass.dr.Kelmend Pallaska, PhD Ass.dr.Lulzim Kamberi, PhD Ass.dr. Merita Emini-Sadiku, PhD Ass.dr. Xhevdet Krasniqi, PhD Ass.dr.Edmond Haliti, PhD candidate Ass.dr.Afrim Poniku, PhD Ass.dr.Arlind Batalli, PhD Ass.dr.Artan Ahmeti, PhD Ass.dr. Rina Tafarshiku, PhD candidate Ass.dr. Mjellma Rexhepi, PhD candidate Ass.dr. Rrezarta Alihajdari, PhD candidate Ass.dr. Besim Morina, PhD candidate Ass.dr. Naim Morina, PhD candidate
Të dhënat kontaktuese:	<b>Klinika e Endokrinologjisë, kati i IV-të, zyra e shefit të katedrës</b>
Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Mjekësisë Interne shtjellon problematikën mbi sëmundjet internistike, sëmundjeve të zembrës dhe enëve të gjakut, sëmundjeve të sistemit respirator, sistemit gastrointestinal, sëmundjeve hematologjike, sëmundjeve endokrinologjike dhe çrregullimeve të metabolizmit, sëmundjeve të sistemit urinar si dhe sëmundjeve reumatizmale.

	Studentët do ta fitojnë aftësinë që të diagnostikojnë sëmundjet internistike, t'i trajtojnë dhe udhëzojnë pacientet nga institucionet primare në ato sekundare dhe terciare.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimet kryesore janë të shtjellohen teorikisht dhe të demonstrohen në praktikë sëmundjet internistike. Të ofrohen njohuri për etiologjinë e tyre, pasqyrën klinike, komplikimet e mundshme, diagnostikimin, diagnozën diferenciale dhe mjekimin e sëmundjeve internistike.
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	<p>Studenti duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-të njoh dhe kuptoj metodat klinike bazë për ekzaminimin e pacientit me sëmundje internistike,</li> <li>-të bëjë diagnostikimin e tyre dhe diagnozën diferenciale,</li> <li>-të ordinoj terapinë dhe të përcjellë klinikisht efektin e saj,</li> <li>-të bëjë diferencimin dhe menaxhimin e situatave urgjente në kushte jashtëspitalore,</li> <li>-të identifikoj rastet të cilat kërkojnë trajtim spitalor në nivelet e shërbimeve shëndetësore sekondare ose terciare, si dhe të udhëzoj pacientin në institucionin përkatës mjekësor,</li> <li>-të përcjellë gjendjen klinike të pacientit pas lëshimit nga spitali, të ordinoj terapinë sipas rekomandimeve ose në marrëveshje me specialistin.</li> </ul>

**Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjëratat	3	1/15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	4	1/15	60
Konsultime me mësimdhënësin	2.5	2/2	10
Puna në terren	1	1	1
Testi, punimi seminarik	1	30	30
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	1	1/15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)		2	2
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>		<b>30 javë</b>	<b>178 orë (7 ECTS)</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me diskutime interaktive, seminare, ushtrime praktike dhe konsultime.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i studentit zhvillohet në tri faza: I, II, III <b>Testet Intermediare (me shkrim)</b> <b>Test Preliminar (me shkrim)</b> <b>Provimi Përfundimtar (me gojë)</b>
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Grup Autorësh. Parimet e Mjekësisë së Përgjithshme. Tiranë, 2002.</li> <li>2. Jameson L, Fauci A, Kasper D, Hauser S, et al. Harrison's Principles of Internal Medicine, 20<sup>th</sup> Edition, International edition, 2018.</li> <li>3. Ralston S, Penman I, Strachan M and Hobson R. Davidson's Principles and Practice of Medicine, 23<sup>th</sup> Edition, International edition, 2018.</li> <li>4. Feather A, Randall D and Waterhouse M. Kumar &amp; Clark's Clinical Medicine, 10<sup>th</sup> Edition, International edition, 2020.</li> <li>5. Vrhovac B, Francetic I, Jaksic B, Labar B, Vucelic B. Interna Medicina, Zagreb, 2003.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Grup Autorësh. Sëmundjet e Zembrës. Tiranë, 2001.</li> <li>2. Spahiu I dhe bp. Pneumoftizilogjia. Prishtine, ?</li> <li>3. Resuli B, Prifti S, Bibolli I, Kajo I, Basho J. Babameto A. Gastroenterologjia. Tiranë, 2000.</li> <li>4. Resuli B, Prifti S, Bibolli I, Kajo I, Basho J. Babameto A. Hepatologjia. Tiranë, 2000.</li> <li>5. Ylli A, Agaçi F. Endokrinologjia, Diabeti, Metabolizmi. Tiranë, 1999</li> <li>6. Grup autorësh. Nefrologjia. Tiranë. 2000</li> <li>7. Tafaj A. Reumatologjia. Tiranë, 2004.</li> </ol>
<b>Hartimi i planit mësimor-Semestri i V-të</b>	
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjërata</b>
<b>Java 1:</b>	Hyrje në propedeutikë; Metodat e ekzaminimit objektiv (fizik); Ekzaminimi i përgjithshëm; Ekzaminimi i kokës dhe qafës
<b>Java 2:</b>	Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit respirator
<b>Java 3:</b>	Anamneza dhe ekzaminimi objekti (fizik) i sistemit kardiovaskular
<b>Java 4:</b>	Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit digjestiv
<b>Java 5:</b>	Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit hemopoetik; Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit endokrin
<b>Java 6:</b>	Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit urogenital; Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit lokomotor
<b>Java 7:</b>	Metodat diagnostike të sistemit respirator, Bronkiti akut; Bronkiti kronik; Emfizema mushkërore; Bronkiektazitë; Astma bronkiale; Insuficienca respiratore; ARDS

<b>Java 8:</b>	Pneumonitë (bakterore, virale, mykotike); Sëmundjet e pleurës; Tumorët e mushkërive; Sarkoidoza; Ekinokoku i mushkerise; Peumokoniozat
<b>Java 9:</b>	Etiologjia, patogjeneza dhe ndryshimet patoanatomike te tuberkulozi; Alergjia dhe imuniteti te tuberkulozi; Testet tuberkulinike; Vaksina BCG
<b>Java 10:</b>	Tuberkulozi primar: format e lehta, format e rënda, pneumonia kazeoze, bronkopneumonia kazeoze, kaverna primare, tuberkulozi miliar i mushkërive, tuberkulozi miliar i gjeneralizuar; Mjekimi i tuberkulozit
<b>Java 11:</b>	Çrregullimet e ritmit te zemres dhe të përçueshmërisë; Pamjaftueshmeria e zembrës
<b>Java 12:</b>	Ethet reumatike; Endokarditet Hipertensioni arterial
<b>Java 13:</b>	Veset e fituara të zembrës; Veset kongjenitale të zembrës
<b>Java 14:</b>	Sëmundjet iskemike të zembrës Vdekja e papritur, Reanimimi kardiopulmonar
<b>Java 15:</b>	Sëmundjet e miokardit dhe perikardit; Sëmundjet e enëve të gjakut

#### **Hartimi i planit mësimor-Semestri i VI-të**

<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>
<b>Java 1:</b>	Sëmundjet e ezofagut
<b>Java 2:</b>	Sëmundjet e lukthit dhe duodenit
<b>Java 3:</b>	Sëmundjet e zorrëve
<b>Java 4:</b>	Sëmundjet e mëlçisë; Sëmundjet e fshikëzës dhe rrugëve biliare
<b>Java 5:</b>	Sëmundjet e pankreasit
<b>Java 6:</b>	Sëmundjet e qelizës hematopoetike amë Sëmundjet e Eritrociteve; Sëmundjet e granulociteve, monociteve dhe makrofagëve
<b>Java 7:</b>	Sëmundjet e limfociteve; Limfomat malinje Sëmundjet neoplazike te qelizave qe sekretojne imunoglobulina; Sëmundjet e shpretkes
<b>Java 8:</b>	Çrregullimet e hemostazës; Sëmundjet e murit të enëve të gjakut; Sëmundjet e trombociteve (çrregullimet e numrit dhe të funksionit të tyre); Çrregullimet e koagulimit të gjakut
<b>Java 9:</b>	Sëmundjet e hipotalamusit dhe hipofizes dhe sindromat klinike qe lidhen me disfunktionin e tyre
<b>Java 10:</b>	Sëmundjet e gjendrave paratiroide dhe çrregullimet e tjera te metabolizimit fosfo-kalcik; Sëmundjet e gjendres mbiveshkore; Çrregullimet e hormoneve seksuale. Çrregullimet e diferencimit të gjinisë
<b>Java 11:</b>	Diabeti mellitus tip I, II, gestacional dhe tipet e tjera specifike te diabetit; Çrregullimet e metabolizmit te yndyrerave, proteinave, ujit dhe elektroliteve; Obeziteti; Kaheksia
<b>Java 12:</b>	Sëmundjet glomerulare te veshkave (primare dhe sekondare)

	Sëmundjet tubulo-intersticiale; Sëmundjet e trashëguara të veshkës; Sëmundjet vaskulare të veshkëve; Sindromi nefrotik
<b>Java 13:</b>	Infeksionet e traktit urinar; Pielonefriti akut dhe kronik; Nefrolitiazë; Tumoret e veshkëve; Pamjaftueshmeria akute dhe kronike e veshkëve; Hemodializa dhe dializa peritoneale; Transplantimi i veshkës
<b>Java 14:</b>	Sëmundjet e reumatizmit inflamator; Artriti akut të ethja reumatizmale; Artriti reumatoid; Artriti juvenil; Lupusi eritematoz sistemik; Sklerodermia dhe Skleroza sistematike progresive; Polimioziti-dermatomioziti; Vaskulitet sistematike
<b>Java 15:</b>	Sëmundjet e reumatizmit degenerativ- Artrozat; Spondiloartritët seronegativë; Sëmundjet metabolike të kockave; Sëmundjet e reumatizmit jashtë-artikular

### Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.*

*Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.*

*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*

*Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*